



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 842/prot.

Tiranë, më 03.10.2024

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall pozicionin e lirë të punës “Specialist” në Sektorin e Promocionit dhe Imazhit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar
2. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
3. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në nivelin Master në profilin e marketingut, gazetarisë ose profile të tjera të ngjashme.
2. Të ketë përvojë pune në fushën e marketingut dhe menaxhimit të fushatave promovionale.
3. Të njohë dhe përdorë shumë mirë programet kompjuterike në kuadër të realizimit të detyrave në ngarkim
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi në të shkruar dhe të folur
5. Të ketë aftësi të organizojë punën në ngarkim me efikasitet, efektivitet, efikasitet dhe sipas afateve të përcaktuara
6. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike

7. Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja (preferohet gjuha angleze).
8. Të jetë i aftë për të punuar nën trynë dhe në një mjedis dinamik pune.

Përgjegjësitë/Detyrat kryesore të “Specialistit” në Sektorin e Promocionit dhe Imazhit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Në kryerjen e detyrave në ngarkim të ketë:

1. Aftësi në përdorimin e mjeteve digjitale të marketingut (Google Analytics, SEO, PPC).
2. Kreativitet për zhvillimin e ideve dhe përmbajtjeve tërheqëse.
3. Aftësi të shkëlqyera në komunikim verbal dhe të shkruar.
4. Njohuri të thella për mediat sociale dhe platformat e marketingut online.
5. Aftësi për të analizuar të dhëna dhe për të gjeneruar raporte.
6. Aftësi ndërpersonale dhe bashkëpunimi me ekipet e tjera.
7. Njohuri për trendet dhe inovacionet e industrisë.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara në nivelin Master. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislationit të arsimit të lartë
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 28.10.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Specialist” në Sektorin e Promocionit dhe Imazhit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”

Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

